

KOSOVA

Ballina: Lil Vlora

Disa intelektualëve u mungon nga një “dërrasë”

U lind në burg dhe vdiq në burg

Pse lejohet shitja e thikave në treg



Lil Vlora

e jashtëzakonshme në bukuri dhe profesionalizëm, shqiptarja numër një në Zvicër për estetikë



Si ia prisha jetën vajzës sime

La familjen për grua tjetër





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD
Gölkaya Resort



SHERWOOD
Gölkaya Lara



SHERWOOD
Divan Resort



SHERWOOD
Pinar Hotel



3UE
Türkiye
Seyahat



GREENWOOD
Kaya Resort



GREENWOOD
Kaya Resort

sherwoodhotels.com.tr | greenwoodhotels.com.tr

+90 444 86 07

E bukura

Ermira Mehmeti, e lindur më 1979 në Shkup, është politikanë shqiptare nga Maqedonia e Veriut. Juriste e diplomuar në UEJL në Tetovë, magjistër në sferën e politikës komparative në Fakultetin e Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër (LSE), doktorant i shkencave juridike në Universitetin e Tiranës. Ndërkohë, krahas shkollimit

ajo u mor edhe me politikë. Ishte deputete në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integrim nga 2011 deri 2016. Por, edhe pse e zonja në politikë, Ermirën e ka karakterizuar gjithmonë edhe bukuria që ka, meqë është ndër politikanet më të bukura në trojet shqiptare.



Mc Kresha dhe fansja (gruaja) e tij

Këngëtari i njohur Mc Kresha ka kohë që është martuar me Erzinen, e cila dikur ishte fanse e Mc Kreshës.

Por, si lindi dashuria ndërmjet çiftit?

“Më kontaktuan që t’i bëja urimin një vajze që më donte shumë. Nuk e dija që ajo ishte Erzina dhe as që po e festonte 30-vjetorin e lindjes.

Më vonë mësova për këtë dhe vendosa të shkoj te shtëpia e saj për t’i bërë urimin”, tha në një intervistë Mc Kresha.

Megjithatë, po të njëjtën ditë, shkaku i shiut, anuloi koncertin, duke pasur më shumë kohë në dispozicion për t’u njohur me fansen e tij.

“Atë natë koncerti jonë u anulua shkaku i shiut dhe unë dola me Erzinen për të festuar ditëlindjen e saj me miqtë dhe familjarët e saj”, shtoi ai.

Ishte po ajo natë ku mes çiftit lindën shkëndijat e para dhe shkëmbyen puthjen e parë...

Sidoqoftë, Mc Kresha dhe bashkëshortja e tij, Erzina, janë prindër të dy fëmijëve: Iza dhe Dini.



Anketë me të rinj

Nuk u besoj politikanëve e as gazetarëve!

*Pse politikanët shumë premtojnë e pak realizojnë?
Pse gazetarët janë të ndarë sipas përcaktimeve politike?
Në këto pyetje përgjigjen të anketuarit tanë...*

ERTRIM HOTI, STUDENT:

-Hë, pyetje me vend që i përshtatet kohës, sepse ngjarjet që po rrjedhin që 25 vjet pas lufte, e në veçanti sivjet, veç po përsëriten.
Sa u përket politikanëve shumë pak u besoj, për të mos thënë fare, sepse premtimet japin sa të duash e realizim pak, për të mos thënë aspak.
Ndërkaq, edhe gazetarët janë ndarë sipas përcaktimeve politike.
Ai që e përkrahë "Vetëvendosjen" e ngritë në qiell këtë parti.
Ai që është përkrahës i luftës së UÇK-së e lartëson PDK-në.
Ndërkaq, ata që edhe më tutje i kanë mbetur besnik ish-Presidentit Rugova e lartësojnë LDK-në.
Pra, nuk kemi raportim real të gazetarëve për ngjarjet dhe ndodhitë që ndodhin në përditshmëri, e në veçanti në politikë!

FIERZË GASHI, E PUNËSUAR:

- "Fjalë shumë...", janë këto premtimet e politikanëve që gjithmonë i japin para zgjedhjeve, e veçmas sivjet, kur edhe dy muaj e pak na ndajnë nga zgjedhjet e 9 shkurtit.
Ndërsa për gazetarët mund të them se i dua, më pëlqen profesioni i tyre, po nuk u besoj edhe aq...

THËLLËNZË YLLI, JURISTE:

- Politikanëve u besoj pak, sepse premtojnë shumë e nuk realizojnë kurrgjë.
E, për ilustrim më kujtohet një humor:
Një deputet shkon në fshat për të kërkuar mbështetjen e fshatarëve.

Në rrugë has disa fëmijë.

U thotë:

"Kur të vij herën tjetër, çka dëshironi t'u sjell nga qyteti?"

"Një palë këpucë", i thotë njëri prej fëmijëve.

"Sa e ke numrin e këmbës?", e pyet ai.
"42", ia kthen fëmija.

"Si 42, ore?! Ti je i vogël", i thotë.

"I vogël jam, por ti më 4 vjet nuk vjen këtu. E deri atëherë më rritet këmba!", ia kthen fëmija.

E për gazetarët s'di ç'të them! Ata nuk premtojnë, sepse s'kanë para as për vete, e lëre më për të tjerët!

Për fund

Besimi në politikanë ka humbur që moti, sepse i japin kosës haptë, e "otkosi" nuk u del kurrqysh!

Diturie Haxhaj

Është i martuar, por e dua!

Jam 22-vjeçare, nga Gjakova. Më besoni, nuk kam dashur të ndodhë kështu, por ja që ndodhi. Gjithmonë i kam urreyer ato që kanë shkuar me burra të martuar, por edhe unë rashë në një grackë të tillë. Ishte pranverë kur u njoha me Tefikun. Më pëlqeu që në shikim të parë, edhe pse e dija se dashuritë në shikim të parë janë jetëshkurtër. Por, Tefiku më la përshtypje... U njoftova me të teksa isha me një shok timin dhe ai erdhi kinse rastësisht! Kur ma shtrëngoi dorën zemra më rrahu fort dhe nisa të dridhesha. Hymë në një restorant dhe porositëm kafe. Ndërkohë im shok shkoi në tualet dhe u vona bukur gjatë. U vonua me qëllim a pa qëllim nuk e di... Unë e Tefiku mbetëm vetëm. Më shikonte drejt në sy. Ishte i patrembur, e kjo më dha të kuptoj se ai kërkonte diçka prej meje...

Kur erdhi im shok nga tualeti, pasi veç i patëm pirë kafet, Tefiku propozoi që ta lëmë qytetin dhe të shkonim te Liqeni i Radoniqit, meqë nata ishte e ngrohtë dhe me dritë hëne. Atje kaluam si e më mirë. Ndeja atje zgjati deri në mesnatë... Pas tri ditësh e takova Tefikun fillikat vetëm në qytet. Pasi më përshëndeti më luti të hynim në ëmbëltoeren që ndodhej pranë nesh. Aty morëm nga një trileqe. Ndërkohë, pa ma thënë asnjë fjalë ma mori dorën dhe ma shtrëngoi lehtë. Rrëqethjet ma përshkuan trupin. E di se u hutova e ai e kuptoi hetimin tim dhe më puthi, pa thënë asnjë fjalë. Dhe, dy muaj rresht vazhduan takimet tona, madje nisëm të shkonim edhe në motelet jashtë qytetit. Mirëpo, një ditë, teksa pija kafe me një të njohur timin, i tregova se dilja me një djalë zeshkan. "Emrin e ka Tefik. Jeton në Çabrat", i

thashë.

"E njoh Tefikun. Është profesor në shkollë fillore", ma ktheu. Dhe, pas një heshtjeje paksa të gjatë, më tha: "E di ti se ai është i martuar?!". "Jo. Nuk më ka treguar!", i thashë. Në ato momente m'u duk se e tërë bota ra mbi mua! Në mbrëmje, kur edhe u takuam si zakonisht, i thashë: "Kam dëgjuar se je i martuar!" "Po", ma ktheu. "Pse nuk më ke treguar?!", i thashë. "Nuk më ke pyetur!", më tha. Dashuria ime në atë kohë ishte në kulm dhe nuk dija si të veproja tutje... U largova prej tij dhe me vrap shkova në shtëpi. Në shtëpi qava shumë, por vendosa të ndahesha, edhe pse e doja dhe ende e dua shumë, ani pse nga takimi i fundit kanë kaluar rrafsh dy vjet...

Valmira



Disa intelektualëve u mungon nga një "dërrasë"!

DËFTESË SHKOLLORE

Abdyr-vep. B. Gajrim shkollë e Mësimi të Këmbës
Mësimi të Këmbës shkollë e Cellopuk me
numër të mësimi të këmbës:

LINDËT E MËSIMIT	NOTAT			
	Trenorish	Trenorish	Trenorish	U shpallur e riut
	I	II	III	
Shërbë	1	1	1	1
Mësim moral e qytetar	2	2	2	2
Mësim jetë e vendl				
Këmbës e recitacion	1	1	1	1
Shkrim e ortografi	2	2	2	2
Udhëzime të fjalës e gramatikë	2	2	2	2
Matem	2	2	2	2
Bakalëria	1	1	1	1
Aritmetikë e gjeometri	1	1	1	1
Gjeometri	1	1	1	1
Histori	1	1	1	1
Mësim natyrë e biologji	1	1	1	1
Shqip	1	1	1	1
Vlerë e punë tërë	1	1	1	1
Këmbës	2	1	1	1
Punë detyrë e punë shpirtërore	1	1	1	1
Gjuhë të mësimi	1	1	1	1
Fundi	1	1	1	1

Ky mësimi data e botës së kësaj në të pestëve Albul.

Cellopuk me 30-7-1959

Draftri: Mësuesja
Andoneta Gaku

Çdo ditë kafënë e mëngjesit e pi me shokë të Redaksisë. Bisedojmë për mbarëvajtjen e punëve në Redaksi, për detyrat e reja, për përditshmërinë tonë, e edhe për politikë, sepse ditë më parë qe fitorja e Trampit në Amerikë...

Madje, temë diskutimi ditë më parë ishte edhe puna e disa intelektualëve tanë, të cilët mundohen ta bindin popullin se janë baballarët e kombit, e, në fakt, secili prej nesh, që i ka kaluar të 70-at, i njeh mirë kush kanë qenë... Këtë herë, bashkë me një shkrimtar tonin shumë të nderuar e të respektuar, u zu në gojë edhe puna e historisë, e cila është shkruar sipas kohës dhe njerëzve të cilët janë marrë me histori. Pra, nga historianët...

Një historian yni në vitet 80 shkruante se Bedri Pejani ka qenë tradhtar i popullit!

E, pas lufte, po i njëjti, ka botuar libër për Bedri Pejani dhe shkruan se Bedri Pejani është hero i kombit. Por, nuk është vetëm ky rast...

ZHURMA E VETURAVE DHE E MOTOÇIKLETAVE NË KUPË TË QIELLIT!

Në pjesën e qytetit ku ndodhen lokalet e Redaksisë, pra në pjesën e qytetit të vjetër pranë Shkollës Fillore "Elena Gjika", ka frekuentim të madh të veturave, të cilat më shumë fishkëlajnë sesa ecin, ngase gjithsecili dëshiron të kalojë sa më shpejt, kurse pengesa ka shumë, meqë, veç rrugës së ngushtë, nxënës dhe njerëz ka me bollëk...

Por, sirenat e veturave nuk janë asgjë karshi atyre që me xhamin e veturës hapur dëgjojnë këngë rep,

herë-herë edhe këngë folklorike me zë shumë të lartë, siç thuhet, në kupë të qiellit.

E, ata as që brengosen nëse ti je në kafene duke biseduar me tjetrin, meqë, në ato çaste, as që mund të komunikosh nga zëri i lartë që vije nga muzika në veturat që ndalen shkak u ngarkesës së madhe, si në pikën kufitare në Vërmicë!

E, edhe më keq është kur kalon ndonjë me motoçikletë: I jep gaz të madh, aq sa detyrohesh t'i mbyllësh veshët!

Dhe, pa dashje, më dalin fjalët: Ne, shqiptarët, nuk i kemi të gjitha dërrasat, sepse shumicës u mungon ndonjë!

Dhe, mu këto gjëra më dhanë idenë për këtë shkrim, për këtë frymëzim jo të mirë, për këtë frymëzim të pafat.

Isa ILAZI

AJO DREQ KARRIGE!



Kosova edhe pas 25 vjet lirie po përballet me shumëçka që të zhgënjën, me shumëçka që të dëshpëron...

Për shumëçka jemi vonuar, po vonohemi.

Neglizhenca jonë, lakmia për interesa më tepër personale, interesa për karrige, për pushtet na ka penguar dhe nuk kemi arritur atë që kemi mundur ta arrijmë...

Për çudi, po e jetojmë një kohë, një përditshmëri, sikur asgjë s'po ndodh dhe gjithçka po ndodh...

Sikur asgjë s'po lëvizë a gjithçka po shkatërrohet... Sikur s'po e shohim veten...

Sikur s'po dimë ta largojmë të keqen...

Sikur s'po dimë çka po na duhet...

As çka po na pengon...

As çka a për çka kemi nevojë...

Shtetet lidere të botës, miket tona, na qëndruan afër. Na përkrahën. Dhe, ende vazhdojnë të na përkrahin, të jenë me ne...

Po ne sikur s'duam ta përkrahim vetveten?!

Jemi bërë pikë e pesë!

Secili duam të jemi lider, bajraktar...

*

Partitë tona gabimet e partive të tjera i qesin para dhe i shohin, ndërsa gabimet e veta i qesin prapa dhe nuk i shohin!

Partitë, të cilat për vetveten mendojnë se janë të pagabuara, gabojnë qysh në start. Koha po ecë...

*

Ndoshta mirë e ka im mik, i cili më thotë se jam bërë pesimist. Po i shikoj gjërat me sy tjetër.

Po, ç'të bëj, janë këta sytë e mi.

Sytë e mi po shohin kështu.

Jo që besoj, por po dëgjoj e ma thonë edhe jo pak vetë që kështu si sytë e mi po shohin edhe të tjerë, të shumtë...

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILLI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILLI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Gani Dili



Ajshe Gjonbalaj në rini

Nazmi Krasniqi u lind në burg dhe vdiq në burg!

Ajshe Gjonbalaj, e lindur në Vuthaj të Malit të Zi më 1948, normaliste e Pejës, e më pas studente në Prishtinë, pjesëmarrëse në demonstratat e studentëve të vitit 1981, në intervistën e gjatë që bëmë me të në vitin 2014 për Revistën tonë, "Kosovarja", ndër të tjerash, tregon:

"Nga grupi ynë na kanë burgosur 18 vetë. Ishim përcjellë në demonstratat e vitit 1981.

Kryetari ynë i grupit ka qenë Rifat Kafexholli. Grupi ishte shumë aktiv dhe i guximshëm, aq sa na quanin "bomba-

çët", grup që njiheshim si minues të Jugosllavisë!

Dy net burg të rëndë i kemi mbajtur në Prishtinë, ditët tjera në Mitrovicë. Një vit u mbajtëm në burg nën hetime në Mitrovicë.

Na kanë rrahur shumë...

Pastaj, na shqiptuan dënimin në Prishtinë.

Rifati u dënua me 20 vjet burg, unë me 13, kurse vëllai im, Beqiri, me 2 vjet. Nuhi Bunjaku me 15 vjet burg, Shaqir Ruhani me 15 vjet, Hazir Xhafolli me 12 vjet burg, Nazmi Kras-

niqi vdiq në qeli në Pozharevc, në burgun qendror.

Interesante: Nazmiu ishte i lindur në burg nga nëna e burgosur dhe vdiq në burg, si i burgosur.

Gjithashtu, shumë prej të burgosurve të grupit tonë kanë mbetur me pasoja të përjetshme, ku dy prej tyre edhe kanë vdekur në burg.

Disa prej tyre edhe tash janë psikikisht keq, e disa me pasoja të tjera fizike. Sidoqoftë, të gjithë kanë qenë të shkatërruar..."

Fol për foto: Lil Vlora



Lil Vlora

e jashtëzakonshme në bukuri dhe profesionalizëm, shqiptarja numër një në Zvicër për estetikë

Vlora Kuçi, për publikun e gjerë e njohur si Lil Vlora, është emër i konfirmuar në fushën e bukurisë dhe estetikës...

Lil Vlora është estetikistja shqiptare më e njohura në Zvicër, e cila në studion e saj "Beauty Lil" arrin transformime të jashtëzakonshme, rezultate që lënë pa fjalë. "Beauty Lil" është bindshëm vendi numër një ku arrihet perfeksioni. Kjo studio estetike vizitohet

nga femra e meshkuj të të gjitha nacionaliteteve dhe, gjithashtu, nga një numër i madh fytyrash publike. Imazhi i këtij numri të "Kosovares", Lil Vlora, vjen ndryshe, duke komentuar disa foto që flasin mjaft për qëndrimet dhe pikëpamjet e saj...





BESIMI NË ZOT?

- Ata që më njohin, por edhe ndjekësit në rrjete sociale, e dinë që unë besimin në Zot e kam të plotë. Për çdo gjë i drejtohem dhe falënderoj Zotin. Nuk ka forcë më të madhe dhe më absolute se forca e Allahut!



“BIG BROTHER VIP KOSOVA”?

- Nuk më ka pëlqyer asnjëherë si format dhe kjo është arsyeja që nuk e ndjek. Kam parë aty-këtu video të shpërndara në rrjete dhe më habisin disa sjellje e veprime. Nuk do ta provoja asnjëherë si përvojë!

JETA E LUKSIT?

- Nuk kam koment.



TAYNA VS MELINDA?

- Meqë më keni vendosur para një zgjedhje të tillë, e që më duhet ta zgjedh një emër, atëherë më duhet të them Tayna.

Ajo është një nga rep-artistet më origjinale në trojet shqiptare.



ANXHELINA ZHOLI?

- Një ndër femrat më të bukura, më të forta dhe më me identitet. Është nga ato femra të rralla që bukuria, sharmi dhe rrezatimi nuk u veniten. E dua shumë.



MESHKUJT QË BËJNË NDËRHYRJE?

- Thjesht, janë të kujdesshëm për pamjen e jashtme dhe duan që në çdo kohë e moshë të shkëlqejnë. Sot nuk është më tabu të bësh dhe t'i pranosh ndërhyrjet. Është krejt normale dhe, kështu, duhet të jetë gjithmonë...

P. DIDDY DHE GJITHË SKANDALI QË E RRETHON?

- Është tmerr. Pas daljes në dritë të gjithë historisë dhe sages që vazhdon, unë nuk mundem më as të dëgjoj rep, zhanrin muzikor që e kam dashur shumë.



CAPITAL T NË SYTË TU?

- Një reper dhe djalosh i mrekulueshëm, ndër më të mirët në estradë. Është tamam siç duhet të jetë një djalë dhe një artist...



TË MBULUARAT?

- Të lumet ato për veten! Uroj që edhe unë një ditë të ndërmarr një hap të tillë...



VITI 2025?

- Uroj shëndet për veten, familjen, miqtë dhe mbarësi për të gjithë! Në "Beauty Lil" viti 2025 do të sjellë edhe shumë risi...

Nderim Neziri



Kurbetçarët më nuk vijnë në Kosovë për t'u çmallur, por për t'i rregulluar dhëmbët!



Kurbetçarët më nuk vijnë për t'u çmallur. Vijnë për përfitime materiale: për ndarjen e trojeve me vëllezërit që janë në Kosovë, për tregti, për t'i rregulluar dhëmbët, për t'u ankuar se këtu nuk punohet asgjë dhe mesele të tjera!

Sivjet, si duket, ka nisur dimri më herët se viteve të tjerë. Kanë nisur të vijnë më herët edhe kurbetçarët.

Dhe, pasi u mundova ta gjej arsyen pse ky

ndryshim, më duket se e kam gjetur...

Nuk kanë ndryshuar vetëm stinët, them me vete, teksa qëndroj në ballkonin e shtëpisë, por kanë ndryshuar edhe fqinjët, edhe kurbetçarët dhe struktura e banimit.

Dhe, teksa qëndroj në ballkonin e shtëpisë, në oborret e fqinjëve shoh vetura me tabela nga jashtë.

Madje, një kushëri imi kalon me veturë rreth shtëpisë sime në shpejtësi dhe nga vetura e nxjerrë krahun e majtë dhe më përshëndet.

"Dukesh i mërziur", më thotë gruaja, e bindur se pak më parë isha mirë dhe me disponim...

Dhe, në vend të përgjigjes mundohem të mos flas, por ta përjetoj në vete gjithë këtë ndryshim kohësh te njerëzit dhe stinët.

"A ke ndonjë mërzi, se kohëve të fundit kemi pasur disa të vdekur që na kanë lënë në pikëllim?", më pyeti pas pak ajo.

Nuk i përgjigjem, por brenda vetes i them se je bërë si axha Dullë, i cili kur rrinte ulur para dyerve të shtëpisë e i fliste dikush, e pyeste a ka diçka kah ju.

E, kur i thoshte kalimtar i jo nuk ka, ai i thoshte pak de, bile diçka...

Më në fund, i them:

"Jo, por shumë gjëra më nuk janë askund! Sapo iku këndej pari kushëri që ka ardhur nga Zvicra. Nuk jam parë kaherë me të. E

kemi kaluar fëmijërinë bashkë.

Dikur, në këtë kohë, zakonisht, dimrat e shtronin tokën me borë deri në gju dhe neve nuk na ndalte as bora e madhe...

E, pak më parë kaloi dhe veç dorën e ngriti e gojën nuk e hapi!"

"A këtë mërzi e ke, a?!", ma ktheu me ironi.

"Jo, oj grua, nuk është ashtu! Një lagje shtëpish i kanë ndërtuar vëllezërit dhe motrat e tij dhe ende nuk kam qenë brenda me i pa!", ia ktheva.

"Hi, allahile, a këtë gajle e ke, a?! Unë ka disa vjet që as për Vit të Ri e as për Bajram nuk i kam vizituar familjarët e mi, e ti më flet për kushërinjtë!", ma ktheu gruaja me nervoz dhe vazhdoi: "Ndal pak dhe shiko rreth vetes - Ku janë vëllezërit tu? Ku janë prindërit tu? Ku janë gjithë ata që i njeh dhe që e jepje kokën për ta?!".

E ka mirë gruaja, por edhe unë nuk e kam keq, e solla në mendje.

E, gjërat gjithmonë po vijnë duke u komplikuar dhe tash vetja më duket sikur personazhi i një romani që përshkruan zyrtarin e shtetit që kish dal te dera e institucionit për të pirë cigare.

Ai, i ngarkuar me punonjësit e vet dhe me përgjegjësinë publike të zbatimit të ligjeve të shtetit, i merr lakmi një gomari, i cili, edhe pse i ngarkuar me barrë në shpinë, do e ketë më lehtë se ai.

"Lehtë e ke ti, o gomar që bart në shpinë barrë e ke mendjen sa një arrë mendon vetëm çka hip në samar!"

Demek, zyrtari pranon të jetë njëfarë gomari që ngarkohet në shpinë, por që kokën s'e ka të lodhur.

Sepse, ta lodhësh kokën edhe me kushërinjtë, më nuk ia vlen.

Dhe, tamam përgatitem t'i them gruas mirë e ke, më ndal inati dhe nuk ia them asnjë fjalë.

VETËM ASLLANI QANË PËR TË KALUARËN!

Sot vijnë e shkojnë kurbetçarët e kush nuk i sheh! Kanë harruar që kemi jetuar bashkë e kemi kaluar fëmijërinë mbi mure oborresh dhe në pemë në dimra të ashpër...

Por, vetëm një moshatar imi ka mbetur në idetë e mia e, ndoshta, ai edhe ma kalon për nga kujtimet dhe nostalgjia. Ai është Asllani.

Ai, sa herë që vjen në Kosovë, më thërrret për kafe dhe qanë duke folur për të kaluarën.

Dhe, kur ishte verës, e pyeta: "Si ndodh që vetëm ti, Asllan, mbete me lot në sy?!".

"Unë jam i vetëm dhe s'kam pasur me kë ta ndaj pasurinë në vendlindje, andaj edhe s'kam pasur me kë të fjalosem!", ma ktheu.

"Vetëm ti po vjen për t'u çmallur se të tjerët po vijnë për tregti e për me i rregulluar dhëmbët, se te ne rregullimi i dhëmbëve është lirë!", i them, më shumë për ta përmbyllur këtë muhabet.

S. Murturi

ZERO
SUGAR FREE



go+
Energy
Drink



Një qepë e një patate nga Mirosala ia dërgova axhës në Turqi!

Gani Berisha, 83 vjeç në kohën kur e bëmë bisedën, tregon historikun e vizitës së tij bërë axhë Osmanit. Ishte një vizitë që moti, e që bëhej për ta përmbushur amanetin e babait të tij, mulla Aliut, që i jepte porosi atij që ta vizitonte vëllanë, Osmanin.

MA KRYEJ NJË AMANET, BIR!

Duke treguar historinë e dhimbshme të vizitës në Izmir, Gani Berisha, thotë: "Babai im, mulla Aliu, para se të vdiste, më tha: "Me ma krye ni amanet, bir! Mos me lënë pa ia gjet derën vëllait tim, Osmanit, në Turqi! Gjeje dhe mbaj lidhje familjare me të!"

Babai ishte dy vjet më i ri se xha Osmani dhe mbante në ndërgjegje kujtimin për të vëllanë.

Dhe, erdhi koha e vdiq babai im, mulla Aliu, por mua nuk më linte të qetë porosia e tij.

Në vitin 1968, për ta plotësuar amanetin e babës, u nisa për në Izmir. Kur i gjeta, jetonin në varfëri të madhe. Ishte skamje e madhe në atë kohë në atë vend.

Në Izmir qëndrova dy javë. Më pritën pleqtë e atij vendi me respektin më të madh, si nip i Osmanit.

Kur u gjenda ballë për ballë me Osmanin, atij i ra të fikët. Dy orë jemi përpjekur për t'ia kthyer shpirtin. Kur erdhi në vete, nuk mund të fliste nga lotët...

NJË PATATE E NJË QEPË NGA KOSOVA...

Kur u këndell, nxora nga çanta pataten dhe qepën. I thashë: "Mihë, kjo qepë është nga bahqja në oborr, ndërsa patatja është nga ara te "Dardha Turke". T'i kam sjell që t'ua marrësh erën e dheut të vendlindjes!"

Pasi u mori erë gjatë, i puthi dhe i vendosi në dollapin e dhomës. Dhe, e qova në vend kërkesën e babës për vëllanë e tij...

E, kur erdhi koha të kthehem në Kosovë, nuk donte t'më lëshonte...

Por, kur u ndava prej tij, mu duk se lashë një pjesë të trupit tim në Izmir!", thotë Ganiu.

NË VIZITËN TJETËR AXHA NUK ISHTE NË JETË...

Të impresionuar nga rrëfimi që u tregoi Ganiu për takimin me xha Osmanin, vëllai i Ganiut, Nebihu, kishte marrë rrugën më 1984 që ta vizitonte xha Osmanin.

Por, nuk kishte arritur ta gjente gjallë,

sepse kishte vdekur katër vjet më parë, më 1980.

"Kur shkova në Turqi, në Izmir, xha Osmanin nuk e gjeta gjallë. U mërzita shumë për axhën, por realiteti nuk ndryshohej...

Dhe, duke lënë një familje jetimësh e duke u kthyer me brenga, u lashë porosinë në një letër që të vinin të na kërkonin në Mirosalë", tregon Nebihu. Dhe, para nesh atë letër e nxjerrë nga kuleta Ademi, nga Izmiri i Turqisë, duke treguar se ja ku ndodhej adresa me shkrimin e Nebihut, e që e ka ruajtur qe 31 vjet në kuletë.

"E kam ruajtur letrën qe 31 vjet. Nuk e kam humbur e as shqyer. E kam ruajtur si sytë e ballit", thotë Ademi, duke e kthyer letrën në kuletë, ku edhe e kishte ruajtur për aq vite...


Ganiu tutje tregon se kur kishte shkuar në vitin 1968 në Izmir të Turqisë, xha Osmani kishte pyetur për çdokënd në Mirosalë...

Dhe, teksa i kujtojnë ato vite, muzgu veç ra mbi Mirosalë e unë duhej të kthehesha në Prishtinë, sepse ajo e diel në Mirosalë veç përfundonte...

S. Krivaça

AUTO
ALBERTI



 /autosallonialberti

Kontakti: + 383 49 373 373
Email: autosallonialberti@hotmail.com



Sami Frashëri

kishte një dashuri tragjike!

Armenia e re nuk mundi ta harronte Shemsedin Samiun, duke u kthyer kështu në Stamboll, më 1882 dhe duke iu dorëzuar në duart e tij. Dhe, do të priste një fëmijë nga kjo lidhje, por...

Shemsedin Samiu, apo Sami Frashëri, siç rëndom njihet ndër shqiptarë, ishte figura qendrore e Rilindjes Kombëtare dhe nga shumëkush merret edhe si babai dhe ideologu i nacionalizmit shqiptar. E, duke jetuar dhe vepruar në kryeqendrën e Perandorisë Osmane, me veprën dhe të bëmat e tij, dimension i Samiut tejkalon atë shqiptar, duke marrë, kështu, përmasa perandorake. Si një poliglott i vërtetë që ishte, botoi e përktheu shumë vepra në gjuhë të ndryshme, duke lënë, kështu, gjurmë të pashlyera në historinë e dy popujve: shqiptar dhe atij turk.

PSE SHKRUANTE NËN DRITËN E QIRIUT?

Para më se 130 viteve, mu përballë Xhamisë së Xhadebostanit, një dritare e

katit të dytë të një vile të bukur bën dritë. Është vila e Shemsedin Samiut, dhoma e Samiut.

Samiu shkruante nën dritën e qiriut! Ky ishte adeti i tij. Zgjohej shumë herët përpara lindjes së diellit dhe shkruante deri sa mbaronte, e tek pastaj flinte.

Edhe pse në atë kohë përdorej gjithandëj llamba me gaz, ai shkruante nën dritën e qiriut, sepse nuk e duronte dot llambën, e kishte neveri, as erën e saj nuk e duronte. Askush nuk e pengonte në dhomën e tij. Madje, edhe kur e zinte gjumi askush nuk e zgjonte!

Kur mbaronte me shkrimin, e kishte zakon të duartrokiste tri herë dhe kjo ishte isharet për vajzën e tij të madhe, Samijen (Erer), që babai i saj tashmë ka mbaruar me shkrimet dhe mund të vinte me vrap e ta përqafonte.

Ajo përgatiste një lloj çaji me konjak dhe

limon, e uleshin së bashku duke biseduar. Ata bisedonin më shumë për letërsinë, madje në disa gjuhë, por më të zakonshme ishin muhabetet për letërsinë franceze, duke biseduar kështu në frëngjisht.

Samija kishte mësuar që e vogël frëngjishten nga babai i saj dhe ishte njohur që e vogël me autorët francezë. Pasi bënin kështu muhabet letërsie, Samija, duke e përshëndetur me "Allah rahatllëk versën", dilte nga dhoma, sepse alimi i madh tashmë duhet të bënte një sy gjumë.

Gota me konjak e shoqëronte edhe në pauzën nga dreka në darkë, kurse në ditët e ftohta të dimrit përdorte vetëm çaj. E, darka ishte shumë e rëndësishme për Samiun. Nga ata që e rrethonin atë, kujtohej se ajo ishte pika përbashkuese e të gjithë familjes dhe koha më e gjatë e



Sami Frashëri dhe Mari Karayan

qëndrim të tij me ta. Darka zgjaste diku më shumë se dy orë dhe aty ai përgatiste tregime më interesante. Shpesh ai rrëfente kujtime nga Trablusgarbi, koha sa ishte i internuar nga Sulltan Abdulhamiti II.

NJË DASHURI TRAGJIKE

Aktorja e bukur dhe e re armene, Mari Karayan ose Mari Nëvart, siç njihet ndryshe, kishte lindur te lagja e famshme "Bejollu" në një familje armene dhe në atë kohë ishte aktorja më në zë e Stambollit.

Ajo popullarizohet shumë edhe duke luajtur rolet kryesore në të gjitha shfaqjet e Samiut, siç ishin "Sejdi Jahja" dhe "Gave". E, sipas profesorit Metin And, jo më kot ajo kishte luajtur në të gjithë shfaqjet e Samiut, meqë ndërmjet tyre kishte një histori dashurie...

Samiu e pëlqente aktoren e talentuar armene, por armenia e bukur, edhe pse ndjente dashuri për dramaturgun, në fillim hezitoi të shfaqte dashurinë e saj, duke u larguar kështu për një periudhë nga Stambolli për në Tiflis.

Por, edhe pse larg, ajo nuk mundi ta harronte Shemsedin Samiun, duke u kthyer kështu në Stamboll, më 1882 dhe duke iu dorëzuar në duart e tij.

E, si rrjedhojë, ajo do të priste një fëmijë

nga kjo lidhje...

Por, edhe pse të dashuruar, dallimet fetare, në radhë të parë nga familja armene, do ta parandalonin çdo hap të vajzës, duke e ndarë atë nga shqiptari.

Ajo u zvetënua, duke e luajtur për herë të fundit në skenën e teatrit "Zonja me Kamelië", të Aleksandër Dymas.

Pas kësaj shfaqje, ku të gjithë i bëri të qajnë, ajo do të vdiste më 8 korrik 1884. Sipas disa dëshmitëve, thuhej se vdiq nga ilaçet që mori për të abortuar fëmijën, e disa thonë se ajo vdiq nga mërzia dhe sëmundja e veremit.

TUBA E FLOKËVE TË EMINESË

4 Maj 1884. Në dy shtëpi të mëdha shqiptarësh në Stamboll kishte filluar dasma. Njëra po bëhej me nuse, e tjetra po përcillet vajzën për në shtëpinë e burrit.

Frashërlinjtë po lidhnin krushqi me familjen me nam të Mirahorëve korçarë. I pari i tyre, Iljaz bej Mirahori, i cili ishte edhe dhëndër i Sulltan Mehmetit II dhe, gjithashtu, besnik i djalit të tij, Sulltan Bajazitit II, kishte krijuar një karrierë dhe një familje me rrënjë dinastie.

Emineja ishte nga kjo farë. Nga një familje me nam ushtarakësh, tani ajo po krijonte familjen e saj me më të zotin e penës ndër

shqiptarë.

Çifti do të jetonte në vilën e madhe në Erenkoj. Aty do t'i jetonin ditët më të lumtura të tyre, e aty do të lindnin edhe të katërt fëmijët e tyre: Samija, Sadija, Sadiu dhe Ali Samiu.

Që nga ditët e para të martesës, Shemsedin Samiu deshi që gruaja e tij të jetë model për kohën, duke u kujdesur për imazhin dhe dukjen e saj.

Që të dy kishin një dashuri të madhe ndërmjet veti dhe, madje, kishin edhe një karakter dhe natyrë të ngjashme me njëri-tjetrin.

Edhe pse vinin nga familjet me nam dhe të pasura, ata ishin shumë modestë, shumë paqësorë, edukatë të lartë dhe që të dy i karakterizonte butësia.

Emineja, edhe pse kishte rroba të shtrenjta, ishte në gjendje që t'ia jepte aty për aty dikujt që i mbetnin sytë te rrobat e saj.

E, Samiu, disa vite më herët, teksa shkruante librin ekskluziv për femrën, të titulluar "Gratë" dhe përshkruante se si duhej të ishin femrat myslimane në periudhën moderne, të krijon përshtypjen se fliste për gruan e tij të ardhshme, Eminenë. Por, Emineja nuk kishte jetë shumë dhe me Samiun do të jetonte vetëm 9 vjet. Dhe, edhe pse shumë shkurtë, ajo do të linte kujtime dhe gjurmë të paharruara në jetën e Samiut, i cili do ta kujtonte gjithmonë, deri sa të vdiste.

Pas vdekjes së Eminesë, Samiu do të martohej me njëren nga kushërirat e tij, por asnjëherë nuk do ta dashuronte sa Eminenë.

Ai, madje, derisa kishte vdekur, e kishte mbajtur një sekret: në dhomën e tij të studimit, që rrallëherë hynte kush, e mbante të fshehur në një qoshe një kuti, në të cilën gjendeshin një grusht flokësh të Eminesë, me një portret të sajën në mes dhe anash me poezi persiane, të cilat ishin shkruar nga vetë dora e Samiut.

FJALËT E FUNDIT TË SAMIUT...

Muaji qershor i vitit 1904 do ta gjente Samiun në një gjendje jo të mirë shëndetësore, Ai sikur e ndjente veten se po largohej nga kjo botë dhe kishte filluar të fliste më shpesh rreth vëllezërve të tij të ndjerë.

I kujtonte më shpesh ata dhe thoshte: "Të gjithë vëllezërit e mi kanë vdekur të shtunave, e edhe unë do të vdes të shtunën". Dhe, një ditë para se të vdiste, e kishte thirrur Samijen, që t'i lexonte diçka nga shkrimtarët francezë. "Më lexo nga Lamar-tini, më lexo Graziellën!"

Kështu ishte një ditë para 18 qershorit 1904, kurse të nesërmen, ditë e shtunë, ashtu siç e kishte ndjerë vetë, rreth orës 9 të mbrëmjes, duke pëshpëritur fjalën e fundit "Allah", kishte mbyllur sytë.

Sh. K.

Jetoj mirë, a nuk punoj asgjë!

Është numër i madh i të rinjve që shëtisin sa në një kafene e sa në tjetrën, në krahasim me ata që punojnë dhe e mbajnë veten e familjen...

Dilema është: Si jetojnë pa punuar dhe si e planifikojnë jetën të rinjtë, e që një pjesë të madhe të ditës e kalojnë në kafene?

Si jetojnë ata që nuk gërzhiten për punë, e në anën tjetër jetojnë mirë, nuk u mungon asgjë?

Në këto dhe pyetje të tjera përgjigjen: Venita - 26 vjeçe, Donjeta - 31 vjeçe dhe Eranda - 22 vjeçe.

E KAM VËLLANË NË ITALI DHE NUK MË LË KEQ

"Kam punuar vitin e shkuar në një butik në qendër të Prishtinës, po pas 3 muajsh pronarja nuk ma vazhdoi kontratën, sepse burri i saj (bashkëpronar) ma vuri syrin!

Momentalisht po rri dhe po pres



mos do më thërras sërish pronarja e butikut të më kthej në punë, sepse sot në shumë dyer të butikëve kërkojnë punëtore.

Nganjëherë po më duket vetja bajat pa punuar, por më mirë të rri në shtëpi e të mos shkoj me punuar gjithfarë pune, e ku paga është minimale. Po më konvenon kështu si jam: Kur më dilet dal me ndonjë shoqe a shok, sepse të dashur momentalisht nuk kam.

E, sa për pare s'po heq keq se vëllanë që është para meje e kam në Itali dhe nuk më lë keq", tha në bisedën tonë Venita.

SHËTITJET S'I NDALI!

"Çdo mbrëmje dal në qytet. Herë-herë rri në kafene deri në orët e vona të natës. Shoqe e shokë kam boll. Kush-tet në shtëpi nuk i kam edhe aq të mira, por prindërit ende punojnë dhe nuk më lënë të heq keq.

Thënë të drejtën, 5 vjet punova në një firmë ndërtimtare në Mitrovicë. Ia mbaja kontabilitetin dhe paga ishte e mirë.

Por, për fa të keq, firma falimentoj dhe pronari i saj u detyrua të më largoj nga firma.

Dhe, nga ajo kohë, meqë materialisht nuk isha mirë, e lash duhanin, por jo edhe kafën.

E, për çka është shoqëria?

Në të shumtën e rasteve ata pagujnë...

Kam qenë e fejuar në kohën kur punoja, por nuk gjetëm gjuhë të përbashkët dhe u ndamë.

Dhe, shyqyr që u ndamë sesa të isha martuar me atë që më mashtroi, madje me shoqen time më të ngushtë! Pra, nuk jetoj mirë, por as nuk heq për asgjë, sepse jam "frajericë" dhe di të gjendem edhe në rastet më të vështira", tha për Revistën tonë, "Kosovarja", Donjeta, nga Mitrovica.

MË E INTERESUAR JAM TË GJEJ BURRË SESA TË PUNOJ!

"Me shoqen time, Besianën, po i përcjellim vazhdimisht konkurset nëpër portale për vend pune gazetarë, sepse që të dyja e kemi kryer gazetarinë në AAB.

Por, e keqja më e madhe për mua është se ende nuk e kam bërë "sefte" me asnjë djalë dhe po pres të vijë princi me kalë!

E, në anën tjetër, djem ka sa të duash, por asnjërin nuk ma do zemra!

Andaj, tash për tash më e interesuar jam të gjej dashnorë sesa punë!", tha Eranda, nga Vushtrria.

PËR FUND

Shumë të rinj nuk punojnë, por ka edhe të atillë që nuk heqin keq.

E, si po ia dalin? - kjo është pyetje për ndonjë shkrim tjetër...

Diturie Haxhaj



Kepi i Vashës në Dibër

Ku ndodhet “Kepi i Vashës?”

Shkëmbi i quajtur “Kepi i Vashës” ndodhet në trojet shqiptare, sipër Qafës Murres në Dibër.

E ka marrë emrin “Kepi i Vashës” sipas legjendës për të.
E, ç’thotë legjenda?

VAJZA MË E BUKUR E FSHATIT DASHUROHET NË FUKARANË!

Në fshat jetonte një vajzë shumë e bukur, e lindur në një familje me gjendje ekonomike të mirë.

Një ditë vajza merr enët e shkon të mbushë ujë në kroin e fshatit.

Atje takon një djalë të varfër.

Vajzës djali i pëlqeu dhe u dashurua në të...

Djali shkoi vetë ta kërkonte dorën te babai i vajzës.

Babai i vajzës së bukur i vuri një kusht.

“Nesër në mëngjes, para gjithë fshatarëve, do marrësh vajzën time në krahë dhe do ngjitesh deri në majën e Kepit.

Në qoftë se arrin në maje pa pushuar, vajza është e jotja dhe ta jap për grua!”, i tha. Djali i gëzuar pranoi.

Të nesërmen në mëngjes, në prani të fshatarëve, djali mori vajzën që e donte në krahë dhe nisi t’i ngjitej Kepit.

Djali arriti pa pushuar deri në maje dhe

sapo lëshoi vajzën në tokë, nga lodhja e tepërt, e lëshoi shpirti.

PO, Ç’NDODHI ME VAJZËN?

Vajza e hutuar nga ajo që ndodhi, e puthi në të dy sytë djalin e vdekur.

Pastaj, ktheu shikimin kah fshatarët që e

shikon nga larg.

Dhe, në çast u hodh nga maja e gurit dhe ra poshtë, duke mbetur e vdekur.

Kështu, maja e malit nga ajo kohë quhet “Kepi i Vashës”, në kujtim të vashës që u flijua për dashuri...

E, rrallë, a?

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkëmbi për Android

ADDRESS APP ON
Google play

KOSOVARIA | 19

Të rinjtë, pasiguria...



Pse lejohet shitja e thikave në treg?

A janë të ndaluara për shitje thikat e llojlojshme, e që marrin jetë njerëzish, të cilat sot janë bërë modë e konflikteve të të rinjve në shkollat tona?

Nëse do bënim një bilanc humbjesh të jetëve të të rinjve në Kosovë, shteti duhet të shfaqë brengosjen më të madhe për praninë e thikave të rinjtë tanë. Rinia, e që përfshin dy nivelet e brezave të parë shkollor, janë të pajisur me thika e grushte hekuri, të cilët në gjuhën popullore njihen me fjalën "boksa" dhe ata i bartin në shkollë për qëllime të caktuara. E, qëllimi pse barten thikat në shkollë nuk do koment! Barten për të kërcënuar njëritjetrin dhe për goditur njëritjetrin. Sot kemi çdo ditë informacione anë e kënd Kosovës, ku përdorimi i thikave ndodh me të madhe mes të rinjve dhe janë evidencuar nga policia edhe therje masive mes nxënësve, si në filma. Dhe, mjerisht, është e vërtetë! E, edhe më keq është gjendja në Shqipëri! Ku i marrin thikat të rinjtë tanë? Dukuria e përdorimit të thikave të brezi i ri, në shumicën e rasteve, rrjedh shkakun e ngacmimeve seksuale dhe i nxitjes provokuese i vajzave me veshje e lakuriqësi.

Por, edhe shkakun e përdorimit të substancave narkotike! E, këto fakte i dinë edhe organet e rendit publik. Mirëpo, dy gjëra janë për debat dhe kujdes, e që duhet të marrin trajtim nga shteti: Ku i marrin të rinjtë thikat dhe kush i sjellë në mesin e tyre, si dhe a ka mundësi në shkollë të krijohet rend e siguri për nxënësit? Sidoqoftë, në tregje shiten thika, grushte hekuri (boksa), ashtu si shitet edhe malli i përditshëm!

INSPEKTORATI DUHET TË NDALJË SHITJEN E THIKAVE!

Është punë e inspektorateve komunale dhe e shtetit që t'i specifikojnë mallrat që mund të shiten në treg. Në mesin e gjërave që nuk duhet lejuar të shiten janë edhe thikat. Tregtarëve duhet t'u ndalohet shitja e tyre. Shteti, po ashtu, duhet të merret me zbuli-

min e origjinës së tyre se nga vijnë. E, nëse ato prodhohen në tregun vendor, shteti duhet ta kuptojë sasinë ku prodhohen ato. Në shkollë duhet avancuar sistemi i kontrollit të nxënësve se çka bartin ata në çantat shkollore dhe në xhepat e tyre... Faktet e përditshme tregojnë se në çantat e rinisë shkollore jo gjithnjë barten vetëm librat dhe fletoret. Kanë edhe thika e boksa, e ndonjëherë edhe pistoletat! Do të ishte e dobishme që kompanitë e sigurimit të jenë pjesë e shkollave, për t'i kontrolluar nxënësit se çka bartin me vete në shkollë. Në këtë mënyrë, mund të zvogëlohen delikuentat, pasojat me fatalitetet dhe therjet me thika e mjete të tjera të forta, e që në gjuhën kriminalistike njihen si armë të ftohta. E, këto fakte flasin se kemi nevojë për veprime konkrete, kurse veprimet do të sillnin rezultate. Pra, siguri për të gjithë.

S. M.

**Blej banesë të gatshme dhe
përfito zbritje deri më 31 Dhjetor!**

**KOMPLEKSI DARDANIA
PRIZREN**

+383 48 450 888

**Blej banesë të gatshme dhe
përfito zbritje deri më 31 Dhjetor!**

**CIMATOWER
FERIZAJ**

+383 49 601 080

Bota është plot me gjëra të bukura dhe TI je njëra prej tyre!



sepse tani kur u rrite dhe u formove të mori egoja përpara. Ego që nuk ngopet kurrë me ty dhe aritjet e tua, sa do i mirë që të jesh ta qet ndërmend se është dikush tjetër aty që është edhe më i mirë se ti, më i bukur se ti, më i pasur se ti, më i gjatë se ti, më i preferuar se ti, më, më, më... Dhe ku mbeti veçantia jote në këtë kaos të krahasimit më të tjerët?

Po shkëputem pak nga rrjedhshmëria e të shkruarit se egoja ma rikujtoi se ne si njerëz jemi racional dhe besojmë në fakte dhe shkencë dhe këtë shprehjen "Ti je unik/e" nuk e beson lehtë dhe nuk ta ngrohë më zemrën aq shumë sepse të duket e përgjithshme dhe shume sipërfaqësore duke menduar se këtë e di se çdo njeri është unik! Unik do të thotë të jesh i pakrahasueshëm. Pikërisht këtu është esenca. A nuk qenke edhe ti njëri ndër ta? Dhe këtë nuk po e mendoj për arsyen se je unik në mes të 8 miliard njerëzve në globin e tërë më gjurmën e gishtit, më ecjen tende, më pamjen tënde (edhe pse në aspektin e dukjes

nuk jam e sigurt pasi kirurgjia estetike ka evoluar aq shumë sa që sidomos ne femrat kemi filluar të krijojmë një stereotip bukurie, ku shumë pak po mbetet nga veçantia jonë). Pasi që kjo fatmirësisht është personale dua ta cekë edhe një veçanti që mua personalisht më fascinon shumë e ajo është pos tjerash edhe rrahjet e zemrës tënde, po ashtu që të bëjnë unik nga të tjerët. A mos ndoshta pikërisht aty fshihet veçantia jote, në zemrën tënde, aty ku ndodhet edhe një vesh i tretë, aty ku mund ta dëgjosh zërin e krijesit!

Të kujtohet gojëdhëna e të parëve tonë „Ma ka ni zemra“. Është pikërisht ai zëri i brendshëm i intuitës tonë që të pëshpërit: Ji vetvetja, kjo është krejt çka kërkohet nga ti, por siç thotë populli "Nga e thëna në të bërë është një mal i tërë".

Edhe pse krahasimi më të tjerët është një prirje e zakonshme njerëzore dhe ka edhe anë pozitive, është shumë i dëmshëm atëherë kur e mohon veçantin tënde dhe kjo mund të ketë pasoja të renda psikologjike që ndikojnë në mirëqenien tënde emocionale dhe mendore. Ne kemi lindur unik por për fat të keq shumë vdesin si kopje. Të mos krahasosh veten nuk është e lehtë por po ta rikujtoi se vlera jote nuk ka peshë dhe as kompensim. Edhe pse ti ndoshta për botën je një më shumë, mos harro se TI me veçantinë tënde në jetën e shumë njerëzve je e gjithë bota.

Këtë varg e gjeta rastësisht në një nga shënimet e mia të kamotshme dhe po të po mos e kisha shkruar vet më tingëlloi pak si ato thëniet nëpër filmat e Netflix-it apo sikur ato përrallat që i dëgjonim si fëmijë dhe fatmirësisht me padjalëzinë tonë fëmijërore dhe ende pa ego të shtrembër e ndjenim cilësinë e të qënurit unik. Ndjesi që me rritjen tënde struket, zvogëlohet, zbehet, bëhet e pabesueshme



PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73




info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges


Shkendije Pacolli



BOOM

**Ç'ndodh nëse
Argjira Osmanajt-Gjyliqit
i thotë dikush
ti nuk mundesh?**

Ç'ndodh nëse Argjira Osmanajt-Gjyliqit i thotë dikush - ti nuk mundesh?



Argjira Osmanaj-Gjyliqi është emër i njohur në botën e biznesit dhe bukurisë. Është nga ato gra, të cilat e dinë saktë se çfarë duan nga jeta dhe përpiqen fort për të qenë në pozicionin e dëshiruar...



Kur flitet për Argjirën flitet për "Hairlezz", rrjetin e qendrave estetike të specializuara në heqjen e përhershme të qimeve me laser në Zvicër dhe Kosovë. Së fundi, ka hapur edhe një sallon

tjetër, që quhet "Bliss Head Spa", ku bëhen masazhe dhe trajtime profesionale për lëkurën e kokës dhe për flokë.

Nëse... do të jetoje në Kosovë, a mendon që do të ishte Argjira që njohim sot?

- Po, sepse kudo që do isha, do ndjekja ëndrrën time për të ndër-tuar diçka unike dhe me vlerë. Ambienti ndikon, por vizioni dhe puna ime janë ato që më formojnë.

Nëse... nuk do të ishte kjo që je në aspektin profesional, me çka tjetër do merresh?

- Ndoshta do të isha marrë me diçka tjetër kreative, si stilimi, artet vizuale ose organizimi i eventeve. Gjithmonë do të kërkoja të bëja diçka që frymëzon dhe ndikon pozitivisht.

Nëse... do ta kishe mundësinë të ndryshoje diçka në botë, nga do t'ia nisje?

- Do të nisja me fuqizimin e grave, duke krijuar mundësi për to që të ndihen të sigurta, të pavarura dhe të suksesshme në çdo fushë.

Nëse... do të kishe mundësi të ndryshoje menjëherë diçka te vetja?

- Ndoshta do të doja të isha më e duruar ose të kisha më shumë kohë për veten, duke gjetur një balancë më të mirë ndërmjet punës dhe jetës personale.

Nëse... do t'i kishe në dispozicion 1 milion euro, cili do të ishte investimi i parë?

- Do të investoja në zgjerimin e "Hairlezz" dhe "Bliss Head Spa" në nivel ndërkombëtar, për ta bërë markën një lider global në industrinë e kujdesit dhe bukurisë.

Nëse... dikush të thotë se ti nuk mundesh, si ia kthen?

- Thjesht, buzëqeshi dhe i tregoj me punën time që gabon. Nuk kam nevojë ta kundërshtoj me fjalë – rezultatet flasin vetë.

Nëse... diçka nuk të shkon mirë në punë, çfarë ndërmerr?

- E analizoj situatën me qetësi, kërkoj zgjidhje kreative dhe konsultohem me ekipin tim për të mësuar dhe për të përmirësuar gjithçka që duhet.

Nëse... laseri do të ishte njeri, çfarë do i thoshe?

- "Faleminderit që më ke ndihmuar të transformoj vetëbesimin e shumë njerëzve! Pa ty nuk do të ishte e njëjta gjë".

Nëse... nuk do të ekzistonin qimet, a do të ekzistonte zinxhiri i salloneve "Hairlezz"?

- Patjetër! "Hairlezz" nuk ka të bëjë vetëm me heqjen e qimeve, por me krijimin e një eksperience kujdesi dhe bukurie për çdo klient.

Nëse... do të duhej të zgjedhje për klientë mes Dafina Zeqirit dhe Dhurata Dorës, do të vendosje për...?


- Zgjedh të dyja, sepse të dyja janë ikona që përcjellin energji të jashtëzakonshme dhe do të ishte kënaqësi të punoja me secilën.

Nderim Neziri



Kush nga të famshmit tanë bën jetë të thjeshtë?

Në botën shqiptare të qenit i famshëm nënkupton edhe të qenit “i paprekshëm”, “ndryshe”, “misterioz”... Disa të njohur tanë preferojnë të rrinë larg vendeve publike dhe për këtë thonë: “Nuk na lënë të qetë!”. Megjithatë, ndër fytyrat publike ka edhe të atillë që nuk e kanë problem të pinë kafe në kafeterinë e lagjes, të dalin në marketin poshtë banesës për të blerë bukë, apo të ecin në këmbë. Kush janë ata?



ÇUN LAJÇI, MË MODESTI PREJ AKTORËVE

Aktori Çun Lajçi është personi më modest dhe më i zakonshëm. Fillimin e çdo dite ia përkushton qenit të tij, të cilin e nxjerr në shëtitje në parkun e “Dardanisë”. Më pas i kryen të gjitha obligimet e mëngjesit: blen bukë, qumësht, mish, e gjërave të tjera të nevojshme. Çuni duket se kënaqet duke jetuar thjeshtë...

FADIL BERISHA, SA MË I AFIRMUAR AQ MË I THJESHTË

Sa më i afirmuar aq më i thjeshtë, kështu mund të përshkruhet sjellja modeste e fotografit me famë botërore, Fadil Berishës. I sjellshëm, i qetë dhe kurdoherë i gatshëm për të ndihmuar. Shoqërohet me njerëz të famshëm, të pasur... Në studion e tij shkojnë nga miset e deri te milionerët. Megjithatë, mbetet i thjeshtë, që gjen kohë dhe mirësjellje për të gjithë.



TEUTA KURTI, KËMBË NËPËR PRISHTINË

Është nga të njohurat që pa pikë problemi i bie rreth e tërthor këmbë Prishtinës, për t'i kryer obligimet e saj ditore.

E veshur thjeshtë, me syze të mëdha dhe çantë në dorë, ecë dhe nuk ndalet.

Teuta duket se nuk mendon fare se të tjerët mund të jenë duke e shikuar...

Këngëtarja shpesh shihet duke blerë rroba dhe gjëra ushqimore, pa pikë problemi apo kompleksi.

Kësaj i thonë "të jetosh me këmbë në tokë".



RONA NISHLIU, YLLI I THJESHTË

Edhe pse vlerësohet lart, gazetarët ia përkëdhelin shumë krenarinë dhe i thonë se sa më e mirë që është - nuk ndryshon, nuk e rrit mendjen, por vazhdon të jetojë thjeshtë.

Pra, Rona është yll edhe në thjeshtësi.

N. N.

Si ia prisha jetën vajzës sime?!

Ia prisha jetën vajzës sime. Nuk e lejoval të jetë me atë që e deshi. Tash jam penduar shumë, por vonë...

Të pesëdhjetat i kam mbushur në pranverën që shkoi. Jam martuar shumë e re, 17 vjeçe.

Kam pasur jetë të mirë, por Zoti ma fali vetëm një vajzë.

Ajo, kur u rritë vetë dëshiroi të shkonte në mjekësi. Dhe, bëra mirë që nuk e pengova, sepse tash punon doktoreshë në qytezën ku jetojmë. Burri im, për fat të keq, është vrarë në luftë dhe që nga ajo kohë jetoja vetëm me vajzën, derisa ajo para katër vjetësh u martua dhe shyqyr Zotit ka krijuar familje.

SI E OFENDOVAL DASHNORIN E VAJZËS SIME?

Por, e keqja në gjithë këtë mesele është se ajo para burrit që e ka sot ishte në lidhje me një tjetër, të cilin e



deshi shumë, por që unë assesi nuk u pajtova.

E, për ta larguar prej saj, madje, disa herë i kam shkruar në telefonin e tij dhe e kam ofenduar, duke i thënë nuk je askush dhe nuk e meriton vajzën time...

Ndërkaq, ai, meqë e deshi shumë vajzën time, përherë ma kthente me fjalët se askush s'ka për ta dashur vajzën time më shumë se unë dhe s'ka për t'u kujdesur kush për të më shumë se unë...

Dhe, ofendim pas ofendimi, një ditë edhe i kishte dhënë fund me vajzën time...

Unë në atë kohë isha shumë e lumtur, sepse dreqi m'i mori mendtë dhe nuk mendoja gjë tjetër veç si ta ndaja vajzën time nga i dashuri i saj!

SHPIRTI I KA MBETUR TE AI...

Kësaj vere u bënë 4 vjet qëkur është martuar ime bijë. Por, edhe pse është bërë me fëmijë, nuk shoh se ka jetë të lumtur, ani pse burri e do dhe e respekton shumë.

Si duket, shpirti i ka mbetur te ai, i mëparshmi...

J.J.



New Year's Celebration at Maritim Marina Bay

ALL 18.900/pax

Celebrate the new year with an exclusive package at Maritim Marina Bay,
featuring luxurious amenities and unforgettable experiences.

Package Includes:

Santa's Gift in your room

Luxury Spa Access for relaxation

New Year's Eve Gala Dinner
at Mandarin Restaurant

Exclusive Party
at Lime Lounge

Free Marina Casino Coupon
Test your luck for 2025

Continental Breakfast
at Mandarin Restaurant

First Brunch at Lime Lounge

Free Access to Marina Cinema

Early Check-in & Late Check-out
for added convenience

Book now and start the year in luxury!

+355 696 041 000 | info@marinabay.al



Babai nuk më pranoi shtatzënë në shtëpi!



Shpeshherë nuk e dija as ku ndodhesha dhe çfarë po ndodhte me mua! Gjendja në të cilën ndodhesha ishte tmerruese! Kur mbeta shtatzënë nuk kisha më kah t'ia mbaja, sepse e njihja mirë familjen time, e në veçanti babanë tim, i cili, kur i tregova se isha shtatzënë, nuk më pranoi në shtëpi...

"Ishte viti 1977, kohë kur edhe pritej lufta, sepse krisma në Drenicë kishte në çdo anë. Si u ndava nga dashnori u nisa drejt Prishtinës, për t'u ikur të njohurve dhe për të gjetur një rrugë për shpëtim. Po atë natë, me të mbërritur në Prishtinë, iu afrova një lokali ku shkruante "cafe bar" dhe u futa brenda. Nuk e dija se si quhej ajo pjesë e qytetit, sepse ndodhesha në një stres të madh psikik. U ula në tavolinën në qosh dhe porosita kafe, edhe pse nuk kisha asnjë lek me vete.

KAMERIERI PA SHQETËSIMIN TIM...

Pas pak mu afrova kamerieri dhe më pyeti çfarë kisha, përse isha e brengosur...

I tregova. Nuk i fsheha asgjë.

Ai ma shikoi barkun tim. I kërkova ndihmë të më ndihmonte të flisja me nënën time në telefon dhe t'i tregoja se isha ndarë nga i dashuri. Në telefonin e shtëpisë u paraqit babai. Më pyeti pse isha e shqetësuar. I thashë: "Jam ndarë nga i fejuari. Por, më e keqja është se jam shtatzënë!" "E ke zgjedhur vetë atë udhë, pa na pyetur neve! Tash bëj ç'të duash!", ma ktheu.

RAHMET I PASTË SHPIRTI PRONARIT TË LOKALIT!

Në atë lokal qëndrova një kohë të gjatë. Nuk lëviza nga vendi as kur hynin e as kur dilnin mysafirët. Ata që vinin uleshin në vendet e lira,

porositnin kafe, i pinin dhe dilnin, teksa më shikonin mua... Dikur vonë m'ua afrova një burrë, i veshur me kravatë dhe mu prezantua si pronari i lokalit. Kur i tregova hallin tim, më tha se mund të flija në lokalin e tij pa paguar... Unë pranova nga e keqja se s'kisha ku të shkoja. Dhe, ma dha njërën nga katër dhomat që ndodheshin në katin e dytë të lokalit. Isha në presion nervor dhe as që më interesonte se ku do flija, por si do ia lidhja "kokën" punës sime... Thënë të drejtën, pronarin më as që e pashë, madje as në mëngjes kur kamerierit ia dhashë çelësin e dhomës dhe e porosita ta falënderonte pronarin për gjestin e mirë në një kohë pa kohë në jetën time.

Miradija



anaderm

Abdomenoplasty

Largimi i lëkurës së tepërt në abdomen



Prof. Dr. Selahattin Özmen
Specialist i Kirurgjisë Plastike dhe Estetike



Rr. Zef Jubani – Veternik,
Prishtinë, Kosovë



+383 (0) 45 707 744
+383 (0) 43 707 744



Nostalgi e një kohe...

Bukur të rrinin kulet!

"E kam marrë letrën tënde mbrëmë dhe jam mërzitur shumë që po të lypin ata, Bajraktarët.
Unë nuk heq dorë prej teje...
Dje, në ara, bukur të rrinin kulet...
Ishe e mahnitshme...
Nuk më hiqet merak për ty nëse të japin.
Por, do gjejmë një dalje dhe do i flakim lotët. Do të të grabis, tek e fundit... Kemi ku të shkojmë nëse vjen puna deri aty...
Kam fol me dajën. Më ka thënë se mundemi me shkua te ai naj ditë, derisa të merren vesh burrat.
Nuk mendoj se zgjat shumë pajtimi, sepse baba yt nuk është njeri i keq, si duket.
Kur të pashë dje në arë, m'u duk se ia more rrezet diellit! Më shumë më ngrohje ti sesa dielli!
Natën edhe mua më ka ardhur zëri yt...
E kam frikën e Bajraktarëve se janë të fortë ata.
Kam dëgjuar se i kanë premtuar mesitit para të majme dhe ai çdo ditë po troket në derën e tyre...
Letrën që do ma dërgosh mbështjelle me mindil, që t'ia marrë erën tënde!"

*

"Sot baba është sëmurë...
Më duhet të vij në arë vetëm, ose me vëllanë e vogël. Mindilin ta jap për me të tregu se jam e jotja dhe e askujt tjetër.
Por, nëse më japin me zor te Bajraktarët, nuk kam rrugë tjetër...
Natën i dëgjova nënën dhe babën kah flitnin.
Nëna nuk pajtohej të fejohej për atë burrin e Bajraktarëve. Por, baba kish qejf unë me shkua te ta. Ndoshta i kanë fol pare...
Oh, Zot, sa shumë u mërzita, pastaj...
Dhe, mendova të iku me ty...
Pra, të ikim sa më shpejt, para se t'më japin për Bajraktarët!
E di se lokja më do dhe po mundohet të mos më fejojnë pa dëshirën time...
Bile, e ka quajtur nënën time kudër që nuk po reagon edhe më ashpër kundër fejesës sime që po vjen...
Nëse më fejojnë për Bajraktarët, më duhet me e përbirë një kerr me therë...
Jeta ime do të shuhet si dielli kur perëndon...
Jam e mërzitur, o Can! Nuk po më zihet

vendi-vend kur po mendoj se mund të mos bëhemi bashkë.
Sot, e hutuar kam hyrë mbathur në dhomë dhe i kam lënë fërkemat...
Pastaj, shpejt e shpejt i kam larë, sepse do më thoshin - ku i kam mendtë..."

*

"Shpirti jem, mindilin e mora dhe do e ruajt tërë jetën. Nëse të qojnë te Bajraktarët, unë do të martohem me mindilin tënd!
Ky mindil që ma dhurove do ma kujtoj fytyrën tënde, lotët tu, mallin për ty...
Në të po i shoh sytë tu të zi, shpirtin tënd...
Nuk do të martohem kurrë me dikë tjetër, edhe pse baba po këmbëngulë se e kam kohën për martesë, kurse nëna, paksa e sëmurë, ka nevojë për dikë që e ndihmon në punët e shtëpisë...
E dashura ime, më duket se asgjë tjetër nuk flitet në familjen tënde veç se si me të fejuar ty!
E, unë, nëse fejohej e martohej ti, si do jetoj?! Çka do më duhet jeta?!"
Yti përgjithmonë...

Can



E kisha një krenari, por burri ma uli kryet!

E njoha të dashurin tim në gjimnaz. U pëlqyem që në ditët e para. Ai ishte një nga djemtë e edukuar, që tregonte pëlqimin me sy dhe gjeste të kujdesshme, sepse fjalët dhe ngacmimet i konsideronte si ofendim, duke qenë se nuk ishte i sigurt për ndjenjat e mia.

Isha e re dhe, pa dyshim, frikësohesha. Andaj, nuk i kushtova rëndësi dhe nuk e dhashë veten pasi nuk doja të gaboja. Rridhnim të dy nga familje me zënka e probleme, por me kalimin e kohës gjetëm mbështetje te njëri - tjetri. Në fillim ishte shok i ngushtë, por me shumë mund u bë i dashuri im...

SHOQET MË THOSHIN: LARGOHU PREJ TIJ!

Sidoqoftë, unë isha nga vajzat që familja më plotësonte çdo gjë, por

prapë kisha ngelur e thjeshtë në veshje dhe sjellje.

Ndërkohë shoqet më thoshin ta lija, sepse nuk ishte në lartësinë time dhe nuk besonin se do të arrinte diçka në jetë. E, në anën tjetër, doja të kisha gjithçka që doja...

Doja që fëmijëve të mi që do vinin në jetë t'ua plotësoja çdo dëshirë, ashtu siç isha rritur vetë.

Nuk më pëlqente që një ditë të fajësoja atë për jetën e keqe, për shqetësimet dhe hallet që të sjell mungesa e kushteve për jetë.

Megjithatë, vendosa të luftoj. Nuk e hodha kurrë poshtë...

LUFTOVA PËR DASHURINË...

Pas gjimnazit bëra "luftë" me familjen për t'u fejuar me të.

Dhe, kur u fejuam të gjithë mendonin se gabova...

Por, pas kryerjes së fakultetit i eci fati: gjeti punë të mirë.

Tash është biznesmen i zoti dhe kemi jetë të mirë e familje të shëndoshë...

R. S.



E vdekura ecte zbathur nëpër borë!

Para hiq më shumë se para katër-pesë vjetësh, në fshatin tim të lindjes qe bërë një lajm i trishtuar se një grua ishte parë duke ecur zbathur nëpër borë!

Para katër-pesë vjetësh në fshatin tim të lindjes kishte vdekur një grua e moshuar, e që ishte e vetme në familje.

Ajo, sa ka qenë gjallë, të gjithë përreth e kishin shikuar me syrin e dhimbjes.

Por, meqë kishte bërë një moshë, i kishte ardhur koha e vdekjes.

Dhe, nga ajo kohë shtëpia e saj kishte mbetur e boshatisur, ndërsa oborri ishte mbushur therra.

Albani, 26 vjeç, që tani punon në ndër-timtar, tregon se si një natë dimri, teksa kthehej në shtëpi, kishte parë me sytë e tij një grua që ecte zbathur nëpër shtegun e borës.

Albani kishte mbetur i stepur: Të vazhdojë të ecë pas saj apo të ndalej...

E PASHË GRUAN QË ECTE ZBATHUR NËPËR BORË!

Duke treguar rrëfimin e asaj nate me borë, Albani thotë:

"Atë natë, pas punës së lodhshme, u ndala me shokë në lokalin e fshatit tonë ku luhet bilardoja, jo për të luajtur, por për të pirë një kafe për relaksim.

Hëna shndriste si të ishte ditë, e bora që kishte rënë një natë më parë xixëllonte me pamje kristali...

Kah ora 10 e natës u përshëndeta me shokë dhe u nisa për në shtëpi, nëpër shtegun që e kishin trasuar kalimtarët para meje.

Dhe, meqë ishte ftohtë, i shpejtova hapat. Por, pas nja 200 a 300 metrash, nga larg pashë një hije njeriu, e që kur iu afrova ishte grua. Ajo ecte zbathur nëpër shtegun prej bore.

U habita shumë. Ishte e pazakontë për dy arsye:

E para, ishte me veshje të bardha;

E dyta, ishte e vetme.

Në çast u ndala. Stepa.

"Çka po ndodh?!", e solla në mendje.

Një herë më shkoi mendja të kthehem

prapa.

Të ikja...

Por, edhe të vazhdoja drejt saj nuk kisha guxim...

Mirëpo, kureshtja ishte e madhe që ta shihja nga afër se kush ishte në atë kohë dhe në atë vend...

Dhe, nisa të ecë pas saj, herë duke u për-pjekur ta zbuloja kush ishte, herë duke u bërë sikur nuk po ndodh asgjë!

E, kur e arrita, pashë se ishte gruaja që kishte vdekur kohë më parë, e cila jetën sa qe gjallë e kaloi në vetmi...

U tmerrova, meqë e dija se ishte e vdekur!

Dhe, kur u afrova shumë afër saj, veç isha në qendër të fshatit dhe mora rrugën djathtas, që qonte te shtëpia ime.

E, kur arrita në shtëpi, isha tërësisht i hutuar, meqë nga momenti kur u largova prej saj disa herë e ktheva kokën pas, sepse frikësohesha se, ndoshta, vinte pas meje...

S. M.



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
vaten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Pse burri im është shumë xheloz?

Jam grua që jetoj jashtë Kosovës. Kam probleme me burrin. Vetëm në tre muajt e parë ka qenë çdo gjë në rregull mes nesh, kurse prej shtatzënisë së parë që kam mbet menjëherë pas tre muajsh martesë, ai i ka tërhequr ndjenjat prej meje!

Fillimisht i ka ikur përgjigjes sime reale se ai nuk është në rregull me ndjenja ndaj meje, duke më thënë je shtatzënë e nuk dua të rrezikoj... Dhe, pas disa muajsh e ka pranuar se nuk po ecë lidhja intime ndërmjet nesh!

Por, në anën tjetër, është shumë xheloz në mua: më ofendon, shan, sillat keq ndaj meje...

Unë mundohem ta kuptoj atë dhe do e kisha kuptuar edhe më shumë sikur të mos e kishte këtë lloj sjellje ndaj meje, por edhe xheloz edhe i padobishëm për gruan, e edhe ofendues, këtë nuk po mund ta kuptoj?!

Të lutem, si të veprojmë me të?

“Mejremja”

Përgjigje:

Ti je ajo që e siguron ekzistencën e familjes dhe punon edhe për të. Pra, do të thotë ai nuk punon! Këtu edhe kemi një shpërputhje ndërmjet jush. Ai është burrë e nuk punon dhe e qon kohën kot, ndërsa ti punon, edhe pse je nënë dhe i ke fëmijët e vegjël, e që kanë nevojë për kujdes prej teje...

E, fakti se ky xhelozon dhe përflakët nga ndjenjat, tregon se ky i ka elementet e mundësive për aktivitet intim, por mund të harxhohet diku tjetër.

Pastaj, krejt çka i mbetet për ty është ofendimi dhe sharja!

Pra, nuk është shumë për t'i besuar, sepse faktet e sjelljes së tij flasin se ai është jo i sinqertë!

Si ta bindi burrin se nuk po e tradhtoj?

Zonja magjistare, jam grua me shumë halle e probleme, nënë e dy fëmijëve.

Burri im ka kohë që dyshon se unë po e tradhtoj, kurse nuk është e vërtetë, se unë askënd nuk e dua pos burrit.

Të lutem, si t'ia bëj të më besoj?

“Gruaja e sinqertë”

Përgjigje:

Unë besoj se ai nuk dyshon në ty, por e ka të zhvilluar psikologjinë e intrigës, e që duke të akuzuar ty e mbulon veten!

Në këtë mënyrë, ai nuk të jep ty aspak kohë që të merresh me të, sepse ai është në ofensivë të përhershme ndaj teje.

Duke të akuzuar ty ai e përshtat veten në hap me nevojat dhe sjelljen e tij, në mënyrë që të mos e kapësh në vepër. E, ti je lodhur duke iu përgjigjur atij çdo ditë se nuk e ke askënd, ndërsa ai del nga shtëpia në drejtim të dëshirës së vet, duke të lënë të nervozuar nga

sjellja e tij, por edhe me shumë pikëpyetje se çka do të ndodhë me ty. Pra, nëse të akuzon përsëri thuaj m'i jep faktet...

Do të ndahemi, apo?

Përhëndetje zonjë, jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde dhe të admiroj për punën që bën.

Jam 44-vjeçare, me profesion profesore, punoj qe disa vjet, e pamartuar.

Para një viti fillova një lidhje me një person nga Gostivari, por që jeton në Zvicër. Dukej se më donte, bisedonim gjatë dhe arsyeshëm dhe u takuam disa herë, për të filluar, më në fund, me rregullimin e dokumenteve për atje.

Në këtë fazë filluan edhe problemet tona. Ai shprehte aq shumë xhelozia sa më akuzonte e më ofendonte, duke më etiketuar se e tradhtoja! Kjo mënyrë e sjelljes së tij vazhdoi disa muaj dhe para një kohe më tha se dëshironte të ndahej!

Si të sillim me të?

“Profesoresha”

Përgjigje:

Jeni njohur me një person i cili nuk krahasohet me mentalitetin tuaj intelektual e as psikologjik! Unë te ai nuk shoh shenja të psikopatisë, e as të defekteve të tjera psikologjike, por shoh qëllim të caktuar, i cili deshifrohet me gatishmërinë për ndarje. Ai është sjell mirë për tërë kohën derisa nuk është hapur kërkesa për rregullimin e letrave tua për të shkuar në Zvicër! Andaj, heq dorë prej tij dhe gjeje personin e kalibrit tënd!

Pse gjërat nuk na ecin mbarë?

Jam një zonjë që i kam kaluar të pesëdhjetat.

Jetoj në Francë. Por, prej se jam martuar (qe 26 vjet), gjërat nuk na ecin mirë e mbarë, sepse kurrë nuk kemi pasur jetë të mirë, edhe pse jemi në Perëndim!

Burri nuk po punon, por po kënaqet

me atë pak "social" që ia japin!
Si do të vazhdojë jeta jonë?

"Duke pritur"

Përgjigje:

Gabimi juaj është se ti nuk punon. E, jeta në Perëndim bazohet mbi punën dhe fitimin nga puna, diçka që juve u ka munguar. E, kjo ka bërë të mos keni krijuar bazë ekonomike.

Gabimi është te qasja juaj dhe ju duhet ta ndryshoni këtë gjendje, duke i lënë me një anë ekzistencën nga pensionimet e hershme, që edhe ashtu nuk u ndihmojnë materialisht, por të punoni nëse jeni të aftë në aspektin shëndetësor.

A do të ndryshojë vjehrra e vajzës?

Magjistare, jam nënë me një problem prej shumë vitesh.

Vajza ime e do një djalë qe 9 vjet, e qe dy vjet janë martuar, por nuk rrinë tërë kohën në shtëpinë e burrit, shkaku i vjehrrës!

A do të ndryshojë vjehrra e vajzës, sepse nuk kam parë akoma nënë të tillë?

"Nëna e brengosur"

Përgjigje:

Aktualisht pak nuse i duan vjehrrat. Sepse, vjehrrat luftojnë që shtëpia të ketë traditë dhe krenari, e nusja të jetë e lavdëruar nga rrethi dhe masa.

Kjo është dëshirë e vjehrrave, por për nuset dhe nënat e nuseve nuk tingëllon kështu.

Nuk ka nënë që ia mendon të keqen djalit të vet, por nëse nusja e tepron, atëherë vlen fjala popullore "për inati të resë ..."

Sidoqoftë, nuk shoh se vjehrra është armike e djalit të vet, por normalisht nuk lejon as të ketë komandant në shtëpi!

Kështu, nuk dua të paragjykoj fajtorin, por ju, para së gjithash, duhet t'i vlerësoni gjërat ashtu si qëndrojnë dhe të keni dozë vetëkritike edhe për vajzën tuaj...

Letra e një nëne...

Jam një nënë 47-vjeçare, vuaj nga një sëmundje e rëndë.

E kam një djalë të vetëm që na e fali Zoti vonë, e pas lindjes së tij burri im vdiq aksidentalisht e më la të përballem me djalin që tashmë është rritur.

Nuk më dhimbset vetja se edhe ashtu kam pasur jetë të rëndë si te baba ashtu edhe në martesë, por nuk di si do jetojë djali...

Jam e sëmurë, por më shumë jam e plagosur për tim bir si do të jetoj pa mua, si do arrijë ta sigurojë kafshatën e gojës...

"Nëna e përplotur"

Përgjigje:

Para së gjithash, Allahu xh. h. ka për të gjithë. Ka edhe ilaçe për të gjithë, ashtu si mund të ketë edhe për ty.

Andaj, nisur nga ky fakt, ka bukë edhe për djalin tënd e për fëmijët e tjerë.

Por, më e rëndësishmja është të shërohesh ti dhe të jetoni bashkë derisa ta shohësh të martuar e me fëmijë.

Mos paragjyko të keqen! Jetoje jetën me dinjitet, por kujto se në botë ka drama shumë të tmerrshme njerëzore që ndodhin në vendet më të zhvilluara dhe sot askush apo pakkush është i lumtur nga jeta dhe pakkush di t'i gëzohet jetës.

E, sa i përket sigurisë jetësore askush nuk jemi të mbrojtur as nuk kemi garanci se do jetojmë deri nesër...

Më mungon fati!

Zonja magjistare, jam vajzë 30-vjeçare, jetoj në Suedi.

E dua një djalë me të cilin shihemi më shumë në vendin e punës, por unë nuk jam e vendosur për askënd, sepse më duket se jam me depresion.

E metë imja është se dashurohem shpejt e pastaj nuk mund t'i shkoj deri në fund asnjë rasti!

Pra, kam probleme me veten time dhe nuk jam e sigurt në rrugën që marrë.

Të lutem, më ndihmo!

"E pashpresë"

Përgjigje:

Ke pasur një lidhje disa vjet me një djalë dhe jeni ndarë. E, shpirti fle

**PËR LEXUESIT
E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

vetëm te ai që, siç thotë populli, "e ka hequr duvakun tënd".

Për të qenë me dikë tjetër duhet kaluar kohë. Tani për tani nuk shoh se je e gatshme për një lidhje të re, sepse truri dhe shpirti duhet të mësohen me një pamje të re dhe me një sjellje të re që vjen përmes personit që do ta gjesh.

A do të vijë ditë të lumtura për mua?

Jam e martuar, kam fëmijë, jetoj me burrë dhe familjen e tij.

Që nga dita e martesës e deri me sot unë nuk jetoj as edhe një minutë të vetëm për veten time!

Jeta ime komplet është vetëm në shërbimin të të tjerëve.

A do të mbarojë ndonjëherë kjo jetë monotone?

Deri kur do vazhdojë jeta ime me këtë ritëm monotone?

"E palumtura"

Përgjigje:

Ti e ke pranuar këtë lloj jetese në atë familje, e kjo kohë ka qenë koha kur e ke dashur burrin shumë dhe kur ke menduar se jetohet vetëm nga dashuria.

Tani e ke kuptuar se nuk jetohet vetëm ashtu dhe gradualisht dashuria është shkrirë në fëmijë dhe familje dhe tani je aty ku je, e kjo pikë është koha kur nuk ndihesh e lumtur.

Por, as të tërhiqesh nuk ke mundësi, sepse ka humbur kuptimi i kësaj tërheqjeje.

Kjo është dashtë të bëhet me kohë, sepse çdo gjë e ka kohën e vet. Molla kur piqet në rremb duhet të vilet, përndryshe bie në tokë e kalbet.

Unë shoh se do të vazhdosh kështu deri kur familja fillon të jetë më bashkëkohore, duke u munduar për fëmijët tu dhe bashkëshortin.



Pse disa burra e lënë familjen për femër tjetër?

*Ndodh shpesh që burri të lë familjen e tij për një grua tjetër dhe pastaj pendo-
het! E, një gjë e tillë shpesh po ndodh në kohën e sotme...*

Statistikat tregojnë se numri i ndarjeve dhe shkurorëzimeve është vazhdimisht në rritje. Shkaqet janë gjithnjë personale.

Është e pamundur të bëhet një klasifikim dhe jo gjithmonë ai që merr vendimin për të ndërprerë marrëdhënien është burri.

Kur një burrë merr vendimin për t'u larguar pasi është martuar dhe ka fëmijë, motivet janë të ndryshme. Ai, mbase, mendon se me gruan tjetër

do ta ketë më mirë, do të krijojë një marrëdhënie të re.

FEMRAT RRALLË E LËNË BURRIN...

Por, edhe partnerja mund të jetojë me të njëjtat mendime, por shpesh përpiqet të jetë më e durueshme, të shohë për të rimarrë atë energji që duket se është shpërndarë gjatë viteve.

Burri tenton të jetë më impulsiv, përveçse të pendohet nga zgjedhja, veçanërisht nëse takimi me një partnere të re përkon edhe me dyfishimin e angazhimeve dhe përgjegjësisve, ku partnerja e re është, gjithashtu, e ndarë nga një marrëdhënie e mëparshme dhe, ndoshta, ka edhe fëmijët e saj.

Nëse është grua që largohet nga shtëpia, nuk ka gjasa që ajo të jetë

në gjendje të pendohet me kalimin e kohës dhe me intensitetin me të cilin burri ndjen ndarjen. Pikërisht për shkak se zgjedhjet e tij, në shumicën e rasteve, janë impulsive, të diktuar nga lodhja dhe nga iluzioni se ekziston freskia që ai ndjen se e ka humbur në marrëdhënien e tij.

CILA ËSHTË KËSHILLA MË E MIRË?

Ndoshta këshilla më e mirë për ata njerëz që janë në një situatë të tillë do të ishte të nxjerrin jashtë keqardhjen e tyre, madje edhe me gruan ose partnerin.

Kërkoni ndihmë, tregoni se doni të gjeni brenda familjes ato motivime që duken të paqarta, sidomos nëse keni fëmijë dhe keni pasur një periudhë të rëndësishme dhe të bukur të jetës.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE